



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUZIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. Dep.
Nr. Ifaq. Broj stranica
Nº. pages

DPK / DMP

Nr. Prot.
B. Prot.
Prot No.

03-2247/12

PRIŠTINA
PRISHTINA
Data
Datum
Date

01
19.06.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16950/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Rafet Rama nga Prishtina, për kundërvajtje nga nen 6 par. 1 dhe 2 e sanksionuar sipas nen 16 paragrafi 1.2 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151,e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 29.11.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI : Rafet Osman Rama, i lindur më 1971 ne Prekaz K. Sekenderaj, tani më vendbanim në Prishtinë rr. Hilmi Rakovica nr. 36/29, me profesion këshilltar në ministrin e punëve te brendëshme, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

I pandehuri në cilësinë këshilltarit politik në ministrin e punëve të brendëshme, ka qen i obliguar me ligj që në afatin ligjor deri me 31.03. 2010, ta deklaroj pasurin e paraparë me ligj, në Agjensionit Kundër Korruzionit ,ku i njëjta nuk e ka dekluaruar pasurin e vetë, të përcaktuar sipas keti ligji.

Me këtëtë ka kryer vepër kundërvajtëse nga 6 par. 1 dhe 2 e sanksionuar sipas 16 paragrafi 1.2 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151, andaj për këtë:

G J O B I T E T

Me gjobë në shumë prej 300(treqind) Euro,të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që aktvendimi të merrë formën e prerë, në dobi të AFQ i drejtësisë në Prishtinë, në gjirologarin rrjetës 1000430070000518,nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhëni e njëjtë do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh, duke ia llogaritur nga 15 Euro në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor është i obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro, në afat dhe xhirrologari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korruzionit , parashtroi kërkesën nr.01/2295/10 të dt 08.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit së përmendor më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur.

Gjatë procedurës u dëgjua i pandehuri i cili në deklaratën e tij, deklaroj se vitin e kaluar kam pranuar një aplikacion dhe nga agjensioni anti korruzion dhe zyra e ministrisë sonë ku shkruan te dhënat personale janë të Rafet Manaj ku kam kërkuar sqarime se a jam unë ky person apo dikush tjetër dhe prej asaj kohe nuk kam marr përgjegjëje se a ishte ky aplikacion për mua a po për dikuj tjetër dhe pasi që mua nuk ma sjell aplikacion tjetër me emër dhe mbiemrë kam menduar se unë nuk jam personi i cili duhet ta mbush ketë formular dhe prej asaj kohe e deri sa jam ftuar në gjykatë asnjë herë nuk kam pas te dhëna se unë nuk paskam dekluaruar pasurin.

Ne qofse mund te gjejë shkresën te cilën e kemi dërguar në Anti Korupsion do tua sjelli si dëshmi, por nëse nuk e gjejë ketë dëshmi deklaroj se kjo e dhanë është e vërtet se i kam përket mbiemrit dhe unë nuk ka marr aplikacion se përndryshe do ta kisha mbushur sikur këtë vit.

Gjyqtari pasi që administroj provat dhe të provuarit e kësaj çështje, në mënyrë të drejt dhe të plotë vërtetoj gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, andaj për këtë e shpalli faktor dhe e dënoi si në diapositiv të këtij aktvendimi. Me rastin e shqiptimit të dënimit Gjyqtari mori për bazë të gjitha rrëthanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posacërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoj këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngashme. ,andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE

Fatmir Behrami

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje ne Prishtinë,në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjës së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykatë dhe pa taksa.

Pranuar më 18.06.2012
019 11:45 Jellecigj